

Njoftim për Pagesat Ndërkombëtare përmes IBAN

Të nderuar klient,

Ju informojmë së në Republikën e Kosovës që nga data 1 Shkurt 2015, të gjitha pagesat ndërkombëtare të kryera nga Türkiye İş Bankası A.Ş. Degët në Kosovë do të realizohen përmes formatit IBAN (International Bank account Number/Numri Ndërkombëtar i Llogarisë Bankare).

IBAN - (International Bank Account Number) - nënkupton numrin ndërkombëtar të llogarisë bankare - i paraqitur me kod alfanumerik me 20 karaktere që identifikon në mënyrë unike llogarinë bankare në nivel ndërkombëtar, i përcaktuar në përputhje me standardin ndërkombëtar ISO 13616.

Është e rëndësishme të theksojmë së IBAN-i nuk është një numër i ri i llogarisë, por thjesht një format i ri, i cili është i njohur ndërkombëtarisht, duke bërë që numrit ekzistues të llogarisë t'i shtohet vetëm XK (të Republikës së Kosovës) si parashtesë.

Standardi IBAN do të aplikohet vetëm për pagesat ndërkombëtare dhe është format parësor për përdorim, meqë rast ky standard do e rritë kualitetin e realizimit të pagesave ndërkombëtare.

Andaj, duke filluar nga data 2 Shkurt 2015, për çdo llogari të klientit ekzistues ose të ri të Bankës tonë në rast të dërgimit apo pranimit të transfereve ndërkombëtare do t'i gjenerohet numri IBAN në përputhshmëri me llogarinë e klientit.

Ndërsa, sa i përketë pagesave vendore, ende do të vazhdon përdorimi i kodit numerik BBAN (Basic Bank Account Number/Numri bazik i llogarisë bankare) me 16 karaktere që identifikon në mënyrë unike llogarinë bankare në nivel kombëtar.

Për më shumë informata, ju lutem vizitoni degën e bankës.